



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 820/5Prot.

Tiranë, më 30/09/2017

V E N D I M

Nr.146, Datë 30/09/2017

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E INTEGRIMIT EVROPIAN
"Mbi auditimin e llogarive vjetore dhe zonave të llogarisë, për vitin ushtrimor
2016".

Pasi u njoha me Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit, me objekt "Për auditimin e llogarive vjetore dhe zonave të llogarisë, për vitin ushtrimor 2016", të ushtruar në Ministrinë e Integrimit Evropian, sipas programit të auditimit nr 820/1 prot, datë 07/08/2017, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

OPINIONI I AUDITUESIT:

Baza për Opinionin

Auditimi u krye në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (*mbështetur në standartet ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 1200²*) kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH dhe ligjit nr 154/2014 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’. Përgjegjësitë tona përshkruhen tek pjesa “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Ministria e Integritimit Evropian dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë. *Kemi kryer procedurat analitike dhe teste të detajeve, pas vlerësimit të kontrollit të brendshëm, për të rritur nivelin e sigurisë së arsyeshme.*

*Në vijim **theksojmë** nevojën për rakordimin e vlerës kontabël me vlerën fizike, sa i takon aktiveve të qëndrueshme, të domosdoshme për t’u reflektuar në pasqyrat financiare të institucionit.*

Opinion i pakualifikuar (me theksim të çështjes):

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritimit Evropian, për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve*), pagesave në para, pasqyrën e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, si edhe shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Opinionin e dhënë, e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Në gjykimin e KLSH-së, mbështetur në standartet ISSAI 1700, dhe ISSAI 1200, pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Integritimit Evropian, paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31.12.2016.

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetja 1

Nga auditimi u konstatua se, mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël nuk është mbështetur plotësisht mbi bazën e parimit të kontabilitetit rrjedhës pra mbi bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara (kontabiliteti rritës) por mbi bazën e parimit të kontabilitetit mbi baza monetare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Si rrjedhim efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (ka ndodhur kur vlerat ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.³

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 15 parashikojnë se pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Sa më sipër konstatuar edhe në likuidimet e muajit janar, të vitit 2016 kryer për fatura për furnizime mallrash apo shërbimesh të kryera në vitin 2015, por që nuk kanë rezultuar të evidentuara si detyrime për t'u paguar në Bilancin Vjetor të vitit 2015 (Llogaria 467 Kreditorë të ndryshëm). Gjithashtu nga auditimi i Pasqyrës së Flukseve të Arkës u konstatua se, totali i pagesave për shpenzime korrente (sipas Pasqyrës së Flukseve të Arkës) pasqyron vlerën e total shpenzimeve korrente sikundër raportohen në Pasqyrën e të Ardhura-Shpenzimeve. *(Sa më sipër trajtohet në mënyrë të detajuar në faqet 22-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandoj:

Drejtoria e Financës (në vijim struktura përgjegjëse në MEPJ, që do të mbulojë këtë aktivitet) të vijoj me kontabilizimet mbi bazën e parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, pasi, kontabiliteti rritës vlerësohet të jetë efektiv për menaxhimin financiar dhe aktivitetet e kontrollit e duke mos u kryer sikundër kërkohet, riskon të çënojë cilësinë dhe sasinë e informacionit të marrë nga pasqyrat financiare, i cili më tej përdoret për qëllime vendimmarrjeje.

Në vazhdim

Gjetja 2

Nga auditimi u konstatua se:

- është kryer pjesërisht inventarizimi fizik i Aktiveve për vitin 2016, vetëm për inventarin në përdorim; ndërsa nuk është kryer inventarizimi për materialet gjendje në magazinë. Si rezultat i moskryerjes së plotë të inventarizimit, gjendja e të dhënave kontabël në Bilancin e vitit 2016, nuk është rakorduar me gjendjen fizike, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 26.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- nga verifikimi i vlerës së reflektuar në Aktivet e Qëndrueshme të Bilancit Kontabël u konstatua se, godina ku aktualisht ushtron aktivitetin MIE nuk është regjistruar nën zërin “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara”. Në aktivin e Bilancit në zërin “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara”, llogaria 212 “Ndërtime e Konstrukione” është paraqitur vetëm për shumën 3,589,761 lekë, e cila përfaqëson vlerën e shpenzimeve për rikonstrukcion të kryera mbi godinën e cila vetë nuk është e kontabilizuar si aktiv i institucionit, në kundërshtim me VKM nr. 508, date 30.07.2014 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (Qendra e Studimeve Albanologjike), tek Ministria e Integritimit European, të objektit-Palestër Sportive së bashku me mjediset e tjera ndihmëse, truallin e ndërtesës dhe oborrit e rrethuar, për tu përdorur për mjedise pune prej kësaj të fundit, sipas formularit, genplanit dhe planimetrisë bashkëlidhur vendimit”. *(Sa më sipër trajtohet në mënyrë të detajuar në faqet 26-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandoj:

Nga strukturat përgjegjëse në MEPJ, që do të mbulojnë këtë aktivitet, nevojitet të kryejnë një proces të kujdesshëm inventarizimi shoqëruar gjithashtu me vlerësimin rast pas rasti të aktiveve për t'u nxjerrë jashtë përdorimit. Sa më sipër, në funksion të pasqyrimit me vërtetësi të gjendjes së aktiveve dhe vërtetësisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare; si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin efektiv të fondeve publike. Gjithashtu, strukturat përgjegjëse në MEPJ, të marrin masa të menjëhershme për të finalizuar procesin e kalimit në pronësi të ndërtesës ku aktualisht Ministria ushtron aktivitetin e saj, pasi të njihet me statusin pronës dhe me masat e marra deri tani nga Qendra e Studimeve

Albanologjike, si edhe të vijojë më pas me regjistrimin kontabël të saj nën grupin e “Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara”

Brenda datës 31.12.2016

Gjetja 3

Nga verifikimi i kryer mbi vlerën e mbetur nga amortizimin i aktiveve u konstatua se, për pajisje kompjuterike në vlerë fillestare 27,783, 698 lekë, norma e amortizimit nuk ishte llogaritur për të gjithë aktivet, pasi për disa prej tyre që ishin të mbartur në vite, nuk kishte të dhëna në librat e magazinës mbi vitin e hyrjes apo atë të përdorimit, kështu që vlera amortizimit për pjesën tjetër është në 301,574 lekë, ndërsa përpajisje zyrë vlera e mbetur është 1,368,714 lekë. Në vijim u konstatua se, amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara në formatin nr. 1, Aktivi i Bilancit (llog. 219), në fillim të periudhës është 75,314,558 lekë dhe në fund të periudhës është 87,547,297 lekë, që nënkupton amortizimin vjetor në vlerën 12,232,739 lekë; ndërsa sipas formatit nr. 7 bashkëngjitur pasqyrave financiare, vlera e amortizimit vjetor rezulton të jetë 11,680,666 lekë, me diferencë për shumën 552,073 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet”; Udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, pika 3.7; Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore”, i ndryshuar (kapitulli2). *(Sa më sipër trajtohet në mënyrë të detajuar në faqet 25-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandoj:

Strukturat përgjegjëse në MEPJ, për sa më sipër, të marrin masa që në cdo rast të kryejnë vlerësimin e aktiveve dhe regjistrimin kontabël të vlerës së tyre, me qëllim përllogaritjen dhe regjistrimin kontabël të vlerës respektive të amortizimit gjithashtu. Përllogaritja e gabuar e amortizimit merr rëndësi nga pikëpajmë e shtrebbërimit të informacionit kontabël (edhe pse pa efekt në rezultat), por që duke pasur impakt në përllogaritjen e vlerës së mbetur të aktivit, mbart risk potencial që mund të shfaqet në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivit, apo të nevojave të tjera si psh ato për riparim, etj.

Brenda datës 31.12.2016

Gjetja 4

Nga auditimi u konstatua se, relacioni dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare paraqitet i thjeshtë, me të informacion të përgjithshëm, ku konstatojmë se mungojnë sqarime të nevojshme për ecurinë e zërave të pasqyrave financiare. Gjithashtu mungon tërësisht shpjegimet dhe analiza e pasqyrës së flukseve të arkës, në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 “Kudri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare”, pika 67, ku përcaktohet se informacioni në pasqyrat financiare duhet të paraqitet në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe pa ekuivok, për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit për të kuptuar pasqyrat financiare, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 26.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve *me donatore të huaj*”; dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik SNKP 1, paragrafi 128. Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm, të cilat duhet ndër të tjera të sigurojnë edhe atë informacion shtesë, që nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare. *(Sa më sipër trajtohet në mënyrë të detajuar në faqen 29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandoj:

Drejtoria e Financës (struktura përgjegjëse, në MEPJ që do të mbulojë këtë aktivitet), të marrë masa që të pasqyrojë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, informacionin rreth zërave materialë, në mënyrë që mungesa e informacionit të mos çënojë proceset e planifikimit dhe vendim-marrjes, nëpërmjet rritjes së kuptueshmërisë dhe transparencës së të dhënave. Nevojitet identifikim i kujdesëm i zërave materiale dhe reflektimi i tyre në shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare të institucionit. Duke konsideruar rëndësinë e shënimeve shpjeguese, nevojitet që çdo zë i shprehur në këto pasqyra duhet të lidhet me referencën përkatëse me to.

Në vazhdim

Gjetja 5

Nga auditimi u konstatua se, për financimet e huaja, edhe pse MIE ka kryer raportime periodike në Ministrinë e Financave, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, ky zë nuk është reflektohet në pasqyrat financiare të MIE-s, jo në përputhje me kriteret e diktuar nga VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë” si dhe me udhëzimin nr.8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”, dhe Udhëzimin nr. 14, datë “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”. (Sa më sipër trajtohet në mënyrë të detajuar në faqet 35-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandoj:

Në vijim, strukturat përgjegjëse në MEPJ, që do të mbulojnë financimet e huaja, të gjejnë mundësinë që, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të evidentojnë në pasqyrat financiare të institucionit, edhe financimin e huaj, me qëllim rritjen e saktësisë së informacionit të gjeneruar nga këto pasqyra, i cili është gjithashtu në funksion të vendimmarrjes efektive.

Në vazhdim

Gjetja 6

Nga krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të Ministrisë⁴ me të dhënat e Drejtorisë së Thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese, konstatojmë se shpenzimet kapitale dhe korrente sipas 3 programeve respektive që menaxhon MIE, nuk përputhen plotësisht, konkretisht:

- Në programin 110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” u konstatuan diferenca në zërin e shpenzimeve kapitale për shumën 7,311 mijë lekë, nga ku MIE raporton shumën 817 mijë lekë ndërsa Thesari në Ministrinë e Financave shumën prej 8,128 mijë lekë;
- Në programin 150 “Mbështetja institucionale në procesin e integritit evropian” u konstatuan diferenca në shumën 6,879 mijë lekë, nga ku MIE raporton 131,253 mijë lekë, ndërsa Thesari 138,132 mijë lekë

⁴ Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 196, datë 30.01.2017

Në përfundim konstatojmë se për vitin 2016, në raportet e monitorimit përgatitur nga Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave, deklarohen total shpenzime të realizuara nga MIE, në shumën 314,313 mijë lekë, ose 14,190 mijë lekë më shumë nga sa raporton MIE, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes vendore”, pika 47, ku kërkohet që përmbledhjet e rishikuara dhe relacionet shoqëruese që shpjegojnë mospërputhjet të dorëzohen deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër-mujorit, në Ministrinë e Financave. Monitorimi në vetvete është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre dhe cënimi i këtij procesi cënon cilësinë e informacionit mbi realizimin e objektivave. *(Sa më sipër trajtohet në mënyrë të detajuar në faqet 35-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandoj:

Ekipet respektive të Menaxhimit të Projektit, të rishikojnë mospërputhjet e konstatuara, të diskutojnë, konsultojnë stafin teknik dhe të shpjegojnë arsyet e mospërputhjeve si edhe veprimet që duhet të ndërmerren ose janë ndërmarrë për të zgjidhur situatën. Pasi të jenë sqaruar arsyet e mospërputhjeve dhe të jenë përcaktuar masat korrigjuese, DEMP të përgatisë dhe firmosë një raport për GMS-në, i cili duhet të përfshijë: (1) Raportin e monitorimit sipas anekseve të miratuara në udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016; dhe (2) Një relacion shpjegues për mospërputhjet e konstatuara ku të përfshihen gjithashtu rekomandime me argumente mbështetëse

Në vazhdim

Konstatim

Kontrolli i brendshëm është pjesë integrale e aktivitetit të vazhdueshëm të njësisë publike. Në kushtet kur aktiviteti i Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE) është bërë pjesë e aktivitetit të Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme (MEPJ), dhe i nënshtrohet kontrolleve të brendshme të saj, rekomandimet për sistemet e kontrollit të brendshëm të MIE-s nuk janë relevante për MEPJ. Për sa më sipër, rekomandojmë që të vlerësohen dhe implementohen (në rast se mungojnë), konstatimet e KLSH si më poshtë:

-Nga auditimi u konstatua se, edhe pse institucioni ka funksionuar sipas Rregullores së Brendshme, e cila përcakton rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Integritimit Evropian, kanë munguar hartimi i Kodit të Brendshëm Etik ose Kodi i Sjelljes, apo udhëzime për zbatimin e etikës, si dhe procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Gjithashtu, njësia nuk ka hartuar një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Nga auditimi u konstatua se, në institucion ka munguar plani vjetor i trajnimeve për punonjësit e administratës, në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafet “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

-Nga auditimi u konstatua se, ka munguar hartimi i një rregulloreje, ku të raportohen dobësitë e kontrollit të brendshëm si edhe caktimi një personi përgjegjës për regjistrimin e çdo dobësie të kontrollit të brendshëm të identifikuar.

-Nga auditim i aktivitetit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), i cili është një “filtër i domosdoshëm” për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, u konstatuan mangësi si: mungesa e rekomandimeve për gjetjet e konstatuara, apo përcaktimi i përgjegjësive për këto gjetje; mungesa e Komiteti i Auditimit të Brendshëm, të cilat mbartin risqe potenciale

ndaj cënimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. (Sa më sipër trajtuar në faqet 8-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R